



---

**FEDERATA E BASKETBOLLIT E KOSOVËS**  
**BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVA**  
**KOŠARKAŠKA FEDERACIJA KOSOVA**

---

*[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com); [www.fbk-ks.com](http://www.fbk-ks.com) ; email: [info@fbk-ks.com](mailto:info@fbk-ks.com); [federata@fbk-ks.com](mailto:federata@fbk-ks.com)*

# RR E G U L O R J A E G A R A V E

## E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, shtator 2007

Në bazë të nenit 21,alineja 2të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Kuvendi i FBK – së në seancën e mbajtur me 8.09.2007 miratoi:

**RREGULLOREN E GARAVE  
NË FEDERATËN E BASKETBOLLIT  
TË KOSOVËS**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohet organizimi dhe udhëheqja me të gjitha garat të cilat në bazë të Statutit janë në ingerencë të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëposhtëm Federata).

**Neni 2**

Federata nëpërmjet organeve të veta, organizon dhe udhëheq me të gjitha garat në Kosovë (në konkurrencën e meshkujve dhe femrave për të gjitha kategoritë)

**Neni 3**

Mënyrën e organizimit, udhëheqjen e garave, organet, trupat dhe personat zyrtar kompetent për organizimin dhe udhëheqjen e garave, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit të pjesëmarrësve në gara, të drejtat dhe obligimet e personave zyrtar në ndeshje, specifikat e organizimit të disa garave si dhe çështjet të cilat kanë të bëjnë me garat zyrtare, rregullohen me këtë Rregullore, Propozicione të garave dhe Vendime të Bordit.

**Neni 4**

Bordi i Federatës mund t'ia besojë udhëheqjen e garave organizatave të tjera, me mundësi të revokimit të autorizimit, të cilat i jep Bordi, si dhe përcakton nivelin e kompetencave, të drejtave dhe obligimeve të cilat i ka organizata e caktuar për udhëheqjen e garave.

**Neni 5**

Propozicionet e garave i miraton Bordi i Federatës. Propozicionet e garave duhet të jenë në përputhje me Rregullat e FIBA –së dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.

## Neni 6

Të gjitha ndeshjet duhet të zhvillohen në bazë të Rregullave të FIBA – s, kësaj Rregulloreje dhe Propozicioneve të garave.

## Neni 7

Klubet janë të obliguara të organizojnë kontrollimin sistematik shëndetësor për sportistët dhe trajnerët në përputhje me Ligjet pozitive dhe aktet e përgjithshme të Federatës.

## SISTEMI I GARAVE

### Neni 8

Sistemin e garave në të gjitha ligat e Federatës e miraton Kuvendi, me propozim të Këshillit profesional.

Miratimi i sistemit të garave detyrimisht duhet të përmbajë: shkallën dhe llojin e garës; numrin e pjesëmarrësve në garë (numrin e anëtarëve të ligës dhe pjesëmarrësve në turne etj); mënyrën e fitimit dhe mënyrën e humbjes së të drejtës për të marrë pjesë në garën e caktuar.

Kuvendi mund ta autorizoj Bordin e FBK për miratimin e sistemit të garave dhe për ndryshimin e tij.

### Neni 9

Kalendarin e garave të të gjitha garave në nivel të Kosovës e aprovon Bordi i Federatës, më së voni 21 ditë para fillimi të garave.

### Neni 10

Sistemi i garave për të gjitha kategoritë e garave precizohet me Propozicione të garave. Propozicionet dhe sistemi i garave aprovohen më së largu 21 ditë para fillimit të garave dhe nuk mund të ndërrohen gjatë edicionit garues, për të cilin janë miratuar. Përgjithësisht mund të ndërrohen nene të caktuara për rangje garuese të caktuara, me pajtimin e plotë të të gjitha klubeve të atij rangui.

### Neni 11

Plasmani i ekipeve në gara përcaktohen në bazë të Rregullave zyrtare të lojës. Në përputhje me suksesin në garën e caktuar, ekipet kalojnë prej një rangui në rangun tjetër.

Në rast që klubi i një rangu të caktuar heq dorë nga garat para fillimit të kampionatit apo vjen deri te zgjerimi i Ligës për mënyrën e plotësimit eventual vendos Bordi i FBK në bazë të propozimit të Këshillit profesional.

#### Neni 12

Ekipeve kanë të drejtë të shtyjnë ndeshjen e caktuar kampionale dhe të kupës, për shkak të paraqitjes së lojtarit të tyre për Reprerentacionin e Kosovës.

### E DREJTA E GARIMIT

#### Neni 13

E drejta e paraqitjes së lojtarëve, klubeve – ekipeve dhe trajnerëve në ndeshjet në kompetencë të Federatës përcaktohen në bazë të: Rregullores për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve, Propozicioneve të garave dhe Aktet tjera të përgjithshme të miratuara nga organet kompetente të Federatës.

Lojtari mund të luaj në ndeshjen e caktuar në qoftë se është : i regjistruar në mënyrë të rregullt për klubin e caktuar dhe i autorizuar nga klubi i tij të luaj ndeshjen e caktuar.

#### Neni 14

Në garat në kompetencë të Federatës mund të marrin pjesë klubet dhe ekipet e klubeve.

Në rangjet garuese të seniorëve dhe juniorëve, një klub, mund të marrë pjesë me vetëm një ekip.

Në rangjet garuese të kadetëve(U 16) dhe para kadetëve(U 14) klubi mund të marr pjesë me nga dy ekipe.

Klubi mund të bartë të drejtën e pjesëmarrjes në rangun e caktuar të garave, në klubin tjetër në përputhje me rregulloret përkatëse të Federatës.

#### Neni 15

Në ndeshjen e caktuar, mund të paraqiten më së shumti 12 lojtarë.

#### Neni 16

Personat e autorizuar të FIBA – s(nga momenti i anëtarësimit të Federatës në FIBA), Federatës ose AOK – ut mund të urdhërojnë doping kontrollin në çdo kohë dhe në çdo ndeshje në kompetencë të Federatës.

Çdo lojtar është i obliguar që pa shtyrje t'i përgjigjet ftesës për doping kontroll.

Lojtari i cili refuzon doping kontrollin suspendohet dhe i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore.

#### Neni 17

Çdo klub është i obliguar që në ndeshje të paraqitet në përbërjen më cilësore. Shkelja e dispozitës nga paragrafi 1 i këtij neni paraqet shkelje disiplinore. Çdo klub është i obliguar t'i respektoj parimet e Fair Play – it.

Bordi i Federatës mund të bëj rangimin e klubeve për sjellje Fair Play, për çdo edicion garues, e në bazë të gjitha ndeshjeve të luajtura në kompetencë të Federatës.

#### Neni 18

Në garat në kompetencë të Federatës, klubet me shkrim, në formularin e caktuar nga Sekretari i përgjithshëm i Federatës, lajmërohen për gara në të cilat në bazë të plasmanit kanë realizuar të drejtën e garimit.

Çdo klub i ligës së parë (Superligës) për meshkuj është i obliguar që më ekipet e juniorëve, kadetëve dhe parakadetëve të marrë pjesë në garat e Federatës.

Klubi së bashku me formularin e paraqitjes, duhet ti paraqet edhe dëshmitë për plotësimin e kushteve për pjesëmarrje në gara, të përcaktuara me Ligje, akte nënligjore, Rregulla të FIBA – s, Propozicione të garave dhe Vendime të Bordit.

Në qoftë se klubi deklaron se nuk do të marrë pjesë në gara, ose nuk deklarohet deri në afatin e caktuar nga Bordi i FBK –së për pjesëmarrje në gara, Bordi mund ti caktojë klubit afat plotësues për paraqitje në gara..

Klubi i cili tërhiqet nga garat pas paraqitjes, bie në një rang më të ulët se rangun në të cilin është dashur të luaj.

Klubi i cili tërhiqet nga garat të cilat kanë filluar, kalon në një rang garues më të ulët se rangun nga i cili tërhiqet dhe garat i fillon nga edicioni i ardhshëm garues.

Klubi me formularin e paraqitjes, duhet ta dorëzojë edhe vendimin e komisarit të garave për regjistrimin e objektit sportiv në të cilën do ti zhvillojë ndeshjet.

Klubi i cili nuk garon një edicion të garave ose tërhiqet nga garat gjatë edicionit dhe nuk paraqitet për edicionin e ri të garave, fshihet nga regjistri i klubeve dhe i humb e drejtat të cilat i takojnë klubeve të regjistruara.

#### Neni 19

Federata është e liruar nga çdo përgjegjësi për organizimin e ndeshjeve kampionale.

## Neni 20

Me qëllim të ruajtjes së integritetit sportiv të garave të basketbollit, Federata ka të drejtë të intervenojë dhe të marrë hapa konkret në çdo situatë, në të cilën një person është në pozitë që të ndikojë në udhëheqje, administratë të më shumë se një klubi.

## Neni 21

Asnjë klub i cili merr pjesë në gara nën organizimin e Federatës nuk mundet të jetë aksionarë në klubin tjetër.

Asnjë person fizik ose juridik nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë, në çfarëdo cilësie të marrë pjesë në udhëheqjen administrative ose sportive në klubin tjetër.

Pronari i klubit privat nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë të jetë aksionar në dy klube.

Përrjashtim nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni, bëjnë rastet kur kemi të bëjmë me klubet e gjinive të ndryshme.

## Neni 22

Organizimi i ndeshjeve, më përparësisht rregullohet me Propozicionet e garave.

## USHËHEQJA ME GARA – PROCEDURA E ANKESËS

## Neni 23

Me gara udhëheq organi kompetent i garave i zgjedhur në përputhje me Statutin e FBK –së.

Të drejtat dhe detyrat e organit kompetent për udhëheqjen e garave përcaktohen me Statut dhe Propozicione të garave.

## Neni 24

Klubet janë të obliguara që organit kompetent të garave, t' ia dorëzojnë të gjitha informatat e kërkuara nga ai, të cilat i nevojiten për mbarëvajtjen e garave.

## Neni 25

Në qoftë se gjatë zhvillimit të ndeshjes, ka pasur situata kontestuese, gjyqtarët dhe delegati i ndeshjes janë të obliguar që ato ti përshkruajnë në raportin e tyre, dhe të kërkojnë deklarata me shkrim nga personat përgjegjës, të cilat deklarata duhet t' ia bashkangjesin raportit.

Në qoftë se njëri prej klubeve ka parashtruar ankesë, gjyqtarët dhe delegati janë të obliguar të japin mendimin e vet në lidhje me ankesën e parashtruar.

## Neni 26

Organi kompetent i garave i regjistron të gjitha ndeshjet, përveç atyre në të cilat është parashtruar ankesa.

Procedura e ankesës më përafërsisht rregullohet me Propozicione të garave.

Organi kompetent i garave nuk mund të refuzojë regjistrimin e ndeshjeve në të cilën nuk është paralajmëruar ankesa.

## Neni 27

Në lidhje me ankesën, në shkallë të parë vendos organi kompetent i garave.

Në vendimin e organit kompetent të garave mund ti parashtrohet ankesa Komisionit Arbitrar të FBK –së. Vendimi i K.A. është definitivë.

## Neni 28

Video xhirimet, fotografitë, si dhe çfarëdo pajisje vizuale, elektronike, digjitale, nuk mund të përdoren për të përcaktuar apo ndryshuar rezultatin e ndeshjes.

Përdorimi i materialeve nga paragrafi 1 i këtij neni është i mundur vetëm për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore.

## Neni 29

Garat në një rang garues, konsiderohen se kanë filluar me zhvillimin e ndeshjes së parë kampionale.

Pas përfundimit të garave organi kompetent i garave, pa shtyrje duhet ta shpallë tabelën përfundimtare për garën përkatëse.

## PERSONAT ZYRTAR TË NDESHJEVE

### Neni 30

Personat zyrtar të ndeshjes janë: delegati, gjyqtarët, gjyqtarët ndihmës, kontrollori dhe gazetarët e akredituar të cilët e përcjellin ndeshjen.

### Neni 31

Delegati n ndeshjes e përfaqëson organin kompetent të garave. Obligimi i delegatit është që të kontrolloj aplikimin e të gjitha Rregullave dhe Rregulloreve për zhvillimin e ndeshjes.

Gjatë zhvillimit të ndeshjes detyrat e delegatit janë:

1. Të përcjellë punën e gjyqtarëve ndihmës
2. Të kërkojë nga organizatori i ndeshjes marrjen e masave preventive për pengimin e shfaqjes së dhunës nga ana e shikuesve dhe pjesëmarrësve të tjerë të ndeshjes.

3. Të përpilojë një raport objektiv, për rrjedhën e ndeshjes, si dhe ti kryej obligimet tjera të cilat dalin nga kjo rregullore dhe Propozicionet e garave.

Në raste të pamundësisë objektive për përpilimin e raportit pas përfundimit të ndeshjes, delegati mund ti dërgojë organit kompetent të garave raportin plotësues Delegatët – kontrollorët kanë të drejtë të bëjnë notimin e gjyqtarëve, në formularët e përcaktuar nga organi kompetent i garave.

#### Neni 32

Persona zyrtar të klubeve në ndeshje, janë të gjithë ata persona të cilët janë të licencuar si të tillë, nga organi kompetent i garave.

Personi zyrtar, i licencuar nga organi kompetent i garave mund të ulet në bankën për lojtarët rezervë, në bazë të dispozitave të propozicioneve të garave. Personi zyrtar i klubit vendas është i obliguar që dy(2) orë para fillimit të ndeshjes të jetë prezentë në palestrën sportive, në të cilën do të zhvillohet ndeshja.

#### DËNIMET

#### Neni 33

Skuadra e cila është pezulluar ose paraqitet në ndeshje me lojtarin i cili nuk është i regjistruar në këtë skuadër, i pezulluar ose është duke vuajtur dënimin, e humb ndeshjen me rezultat 2:0 dhe fiton zero (0) pikë në tabelën e klasifikimit.

Në qoftë se një skuadër në këtë mënyrë i humb dy (2) ndeshje, atëherë automatikisht largohet nga garat e mëtutjeshme dhe kalon në një rang më të ulët të garave.

#### Neni 34

Në qoftë se organi i cili udhëheq garat, në procedurën e zbatuar, në mënyrë të pakontestueshme e vërteton se rezultati i ndeshjes në mes të dy skuadrave është kurdisur, atëherë të dyja skuadrat largohen nga garat dhe bien në një rang më të ulët.

#### PLOTËSIMET E RREGULLORËS MBI GARAT E FBK-së

#### Neni 35

Skuadra e cila pa arsye nuk paraqitet në zhvillimin e ndeshjes e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:20 dhe i takon zero (0) pikë.

#### Neni 36

Skuadra e cila është fajtoare për ndërprerjen e ndeshjes e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 00:20 dhe i takon zero (0) pikë.

#### Neni 37

Skuadra e cila aktivizon lojtarin e licencuar i cili njëkohësisht luan edhe për ndonjë skuadër tjetër jashtë Kosovës humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:20 dhe i takon zero (0) pikë.

#### Neni 38

Skuadra e cila pa arsye e braktisë fushën e lojës në pjesën e rregullt të garave e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:20 dhe i takon zero (0) pikë.

#### Neni 39

Në rastet e përsëritura të shkeljeve nga nenet 35,36,37 dhe 38 skuadra automatikisht largohet nga garat e mëtutjeshme dhe bie në një rang më të ulët të garave.

#### Neni 40

Skuadra e cila pa arsye e braktisë fushën para përfundimit të lojës në ndeshjen e PLAY-OFF-it ( gjysmëfinale dhe finale) automatikisht diskualifikohet nga garat e mëtutjeshme dhe bie në një rang më të ulët të garave.

#### Neni 41

Në qoftë se gjyqtari i parë merr vendim mbi ndërprerjen e ndeshjes pasi nuk eksitojnë kushtet mbi vazhdimin e saj për shkak të tollovisë (tifozeve) të shkaktuara, atëherë ndeshja regjistrohet me rezultat zyrtar 20:0 në të mirë të skuadrës mike ndërsa skuadrës vendase i takon zero (0) pikë, me përjashtim në qoftë se në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet se ndërprerja është shkaktuar me fajin e skuadrës mike. Në këtë rast skuadra mike e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:20 dhe i takon zero (0) pikë.

#### Neni 42

Në qoftë se skuadra gjatë lojës mbetet me më pak se dy (2) lojtarë në fushë e humb ndeshjen për shkak të mos përfundimit të lojës.

Në qoftë se skuadra, e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen nuk udhëheq në rezultat, atëherë ndeshja regjistrohet me rezultat 2:0 në të mirë të saj.

Në qoftë se skuadra e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen udhëheq në rezultat, atëherë rezultati deri në kohën e ndërprerjes mbetet i vlefshëm.

Skuadra e cila e humb ndeshjen në këtë mënyrë e fiton një (1) pikë në tabelën e klasifikimit.

#### Neni 43

Në qoftë se skuadra është larguar nga gara për shkak të dy (2) ndeshjeve të humbura me rezultat zyrtar (0:20) ose i braktisë garat dhe deri në çastin i ka zhvilluar gjysmën ose më tepër së gjysmën e ndeshjeve rezultatet e arritura janë të vlefshme, ndërsa ndeshjet vijuese regjistrohen me rezultat zyrtar 2:0 në të mirë të skuadrave kundërshtare.

Në qoftë se skuadra i ka zhvilluar më pak se gjysmën e ndeshjeve atëherë rezultatet e arritura anulohen (fshihen) dhe të gjitha regjistrohen më rezultat zyrtar 2:0 në të mirë të skuadrave kundërshtare.

#### Neni 44

Dënimet për shkelje të kësaj rregulloreje dhe propozicioneve të garave, përcaktohen me propozicione të garave për edicionin përkatës të garave, të cilat i miraton Bordi i FBK – së.

### DIPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 45

Bordi i FBK – së mund të marrë vendime të posaçme ti rregullojë çështjet cilat nuk janë rregulluar me këtë rregullore.

#### Neni 46

Interpretimin e kësaj Rregullore e bënë Bordi i FBK.

#### Neni 47

Kjo Rregullore hyn ne fuqi në ditën e aprovimit.

Kryetari i FBK  
Erolld Belegu